



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Rektor
Prof. Dr. Marjan DEMA

Nr. Prot.: 3/596
Datë: 1/12/2017

Senati i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" bazuar në kërkesën e Këshillit të Fakultetit të Filologjisë për futjen e gjuhëve të huaja të cilat i ofrojnë si lëndë zgjedhore në të gjitha njësit akademike të UP-së. Në mbledhjen e mbajtur më 07.11.2017, mori:

V E N D I M

- I. Në të gjitha programet e studimit që ofrojnë njësit akademike të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" e të cilat figuron lënda gjuhë e huaj, studentët do të kenë mundësin që të zgjedhin gjuhën përkatëse që ofrohet në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Prishtinës. Ligjëratat nga këto lëndë do të organizohen dhe mbahen në Fakultetin e Filologjisë.
- II. Obligohet Fakulteti i Filologjisë, që mbajtjen e ligjëratave, ushtrimeve dhe krijimi i grupeve të organizojë në Departamentet përkatëse pran këtij Fakulteti.
- III. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Këshilli i Fakultetit të Filologjisë në mbledhjen e datës 21 qershor 2017 ka propozuar që përveç gjuhës angleze që organizohet si gjuhë e huaj në njësit akademike të UP-së, të kenë mundësin të inkuadrojnë edhe gjuhë tjera, në të gjitha njësit ku figuron gjuhë e huaj. Mbajtja e ligjëratave dhe ushtrimeve ofrohet nga Departamenti përkatës në Fakultetin Filologjisë, për të gjithë studentët e njësive akademike që dëshirojnë të zgjedhin gjuhën përkatëse në të cilën është e akredituar në Fakultetin e Filologjisë. Senati i Universitetit të Prishtinës konsideroi të arsyeshme kërkesën e Këshillit të Fakulteti të Filologjisë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi t'u dorëzohet:

1. Arkivit të UP-së;
2. Sekretarit të Përgjithshëm;
3. Njësive akademike të UP;
4. Shërbimi financiar të UP-së;
5. Zyrtarit Ligjor të UP-së dhe
6. Zyrës për Çështje Akademike.



Senati i Universitetit të Prishtinës

Prof. Dr. Marjan Dema – Rektor